



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. _____ Prot

Elbasan, më ____ / ____ / 2025

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS -“Blerje Asfalto beton”

LLOJI PROÇEDURËS- “Procedurë e hapur e thjeshtuar – mallra”- Marreveshje Kuader

KODI CPV –

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT - 2.495.626 (dy milion e katerqind e nentëdhjet e pese mijë e gjashtëqind e njetzet e gjashte) lekë pa tvsh.,

I mbajtur sot me date **10.05.2025** ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e kriterëve per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjen si me poshte:

Shtojca 8

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Kriteret (b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”

Pika a) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrate tatimore për gjatë tre viteve të fundit, 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të prokuruar.

2.2.2 Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2024 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifatat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit.

Kriteri **2.2.1** është percaktuar duke u bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure, si dhe referuar nenit 43 dhe nenit 55 VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3,e LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

Kriteri **2.2.2** është vendosur bazuar ne nenin 76, pika 2 te LPP si dhe ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e pervojës se meparshme te realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 55 pika 4 gërma "b" te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,si dhe bazuar ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te paraqesë çertifikaten e meposhte:

- **ISO 9001:2015 ose ekuivalente** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë“ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Çertifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Kriteri **2.3.2** është vendosur ne perputhje me Nenin 40 pika 6 germa c te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, bazuar ne nenin 44 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar ne nenin 79 te LPP.

Ky kriter është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertojë të jetë i pajisur me certifikatën e menaxhimit të cilësive gje e cila krijon bindjen dhe sigurinë të AK që ky OE do të ofertojë produkte të certifikuara të një cilësie të mirë e në përputhje me standartet ndërkombëtare të cilësive.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë një kamion veteshkarkues (me kapacitet mbajtes minimalisht 7 ton) për transportin e mallit objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- **Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;**

ose

- **Kontratën noteriale të marrjes me qira të mjetit,** shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për atomjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjetit, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi, ose me qira ose të ketë kontratë noteriale furnizimi për “Impiant prodhim asfalti”.

Ky kriter është vendosur pasi është në përputhje me objektin e prokurimit dhe bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri autoriteti arrin të plotësojë nevojat e elementeve të asfalto betonit si dhe duke marrë parasysh karakterin e vazhdueshëm të kontratës për të garantuar furnizimin dhe realizimin me sukses të kontratës dhe në përputhje të plote me natyrën e objektit të prokurimit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin për furnizimin me “Impiant prodhim asfalti”, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Njësia e prokurimit

Ilda Tavanxhiu

Gazmend Gaxhja

alessandro abdiaj